



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPÇTINA VITINA

Pravur - Prapësues Mënysh	05.12.2022		
Nr. i Organizatës / Nr. i Shoqërisë	Numërtori	Shtetësi / Përligje	Vlera / Madhësia
01-110/05-1361			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

RREGULLORE

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS.29.09.2022**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, shkronja c të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës Kosovës, (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, nenit 2, paragrafi 1 dhe 2), lidhur me neni 9 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008), në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 36.2, shkronja c të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kërkesën me Nr. 43-870/5, e datës 24.10.2022 nga MAPL-ja, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.11.2022, nxjerr këtë

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES

PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS.29.09.2022

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoja komunale me Nr. 01-110/05-1057, e datës 29.09.2022.

Neni 2

Te rregulloja bazë, neni 11, pika 11.3, pika c ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë: **“dru teknik për m³ në shumë prej 3.00€”**.

Neni 3

Te rregullorja bazë, neni 12, paragrafi 12.1.8, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë: **“Qiradhënie e banesa jepet duke u bazuar në Ligji Nr.03/L – 164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Komuna gjatë dhënies me qira të këtyre banesave duhet t’i ketë prioritet personave që kanë më shumë nevojë për banim, ndërsa objektet që janë në pronësi të komunës jepen përmes ankandit publik dhe legjislacionit në fuqi”**.

Neni 4

Te rregullorja bazë, neni 28, paragrafi 28.1 i rregullores bazë pas fjalës “administrative“ i shtohet fjala **“kategorisë së dytë”**, ndërsa pjesa tjetër e tekstit bazë të nenit përkatës mbetet e pandryshuar.

Neni 5

Te rregullorja bazë, neni 23, pjesa e katër ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë: **“Mospërfillja e pagesës së taksave së paku pas dy vërejtjeve do të rezultojë me iniciimin e procedurës kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Kundërvajtje Nr. 05/L-087.**

Neni 6

Te rregullorja bazë, nenit 41 i shtohet pika 41.5 me këtë përmbajtje: **“Procedurën për sanksionimin e kundërvajtësve me gjobë, duke përfshirë nenet bazë të rregullores nga neni 38, 39, 40 dhe 41, ndëshkimet kundërvajtëse bëhen nga Drejtoria për Inspeksion.**

Neni 7

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

Neni 8

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen.

Viti, më 30.11.2022

KUVENDI I KOMUNES SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

